

PJESA E PARË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Autoriteti

Kjo metodologji hartohet në zbatim të nenit 87 pika 4 të Ligjit nr.43/2015, “ Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe në përputhje me Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe Procedurave të ERE-s.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj metodologjie, është përcaktimi i çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit bazuar në parime të qarta të llogaritjes së kostove që lidhen me këtë shërbim, dhe detajimi i të dhënave të nevojshme për përcaktimin e çmimeve të drejta dhe transparente.

Neni 3

Objekti

Objekti i kësaj metodologjie është llogaritja e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga furnizuesi i mundësisë së fundit për konsumatorët fundorë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 86 të Ligjit nr.43/2015 “ Për sektorin e energjisë elektrike”.

Neni 4

Zbatimi

Kjo metodologji do të zbatohet për të licencuarin e ngarkuar për shërbimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit në sektorin e energjisë elektrike, i caktuar në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të nenit 87 të Ligjit nr.43/2015 “ Për sektorin e energjisë elektrike” .

Neni 5

Përkufizime

Fjalët dhe frazat e përdorura në këtë Metodologji do të kenë kuptimet e mëposhtëme:

- a) **Ligji për energjinë** do të thotë Ligji nr 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike.
- b) **Bordi i ERE”** do të thotë organi vendimarrës i ERE-s, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”
- c) **ERE** do të thotë autoriteti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin 43/2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror.”
- d) **Licensë”** është një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.
- e) **Furnizues i mundësisë së Fundit (FMF)** do të thotë një person i pajisur me licencë për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike, i caktuar nga ERE për të ushtruar funksionin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit sipas ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Ai ofron për një periudhë të kufizuar kohe shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara ndaj konsumatorëve, të cilët nuk kanë mundur të kontraktojnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre.
- f) **Çmimi i furnizimit të mundësisë së fundit** - do të thotë çmimi i ofruar nga furnizuesi për të mbuluar kostot e tij të arsyeshme për të siguruar furnizimin me energji elektrike për periudhën për sa është caktuar si Furnizues i Mundësisë së Fundit.
- g) **Kosto direkte të furnizimit me pakicë** - do të thotë kosto administrative (që nuk lidhen me energjinë) që lidhen me kryerjen e funksionit të FMF, e që miratohet nga ERE.
- h) **Procedurë** - do të thotë tërësia e veprimeve, që kryhen për zbatimin e legjislacionit në fuqi.

PJESA E DYTË

PERCAKTIMI I CMIMIT TE SHITJES SE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SE FUNDIT

Neni 6

Metodologjia per percaktimin e cmimeve të Furnizuesit te Mundësisë se Fundit

1. Çmimi për grupe të ndryshme të konsumatorëve mund të ndryshojë vetëm deri në atë masë sa ndryshon profili i ngarkesës së grupeve të konsumatorëve.
2. Axhustimi/korigjimi i Kostos direkte do të bëhet sipas parimit ex-post.
3. Tarifa që FMF do të aplikojë/ngarkojë tek klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë për periudhën e livrimit, mbi të cilën do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit i cili vendoset nga Rregullatori.
4. FMF në çdo rast, duhet t'a sigurojë energjinë për furnizimin e konsumatorëve të kësaj kategorie, duke e blerë në treg të parregulluar në përputhje me Rregulloren e miratuar nga ERE me vendimin nr. 103, date 23.06.2016 ose nga prodhuesit me perparesi.
5. Kostot e imbalancave do të llogariten dhe faturohen në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut dhe akteve të tjera fuqi.
6. Marzhi i Furnizimit do të jetë një përqindje fikse e aplikuar mbi koston e blerjes së energjisë nga FMF sipas përcaktimeve në pikën 4 të nenit 6, e cila duhet t'i kthejë furnizuesit një kthim të arsyeshëm në mënyrë që të kompensojë riskun e tij të furnizimit
7. Marzhi me pakicë nuk duhet të kalojë normën prej 3% të kostot së blerjes së energjisë elektrike.
8. Konsumatorët e FMF do të paguajnë tarifat përkatëse të furnizimit si dhe të gjitha tarifat përkatëse të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes, në përputhje me nivelin e tensionit ku konsumatori furnizohet.
9. Kostot, të cilat varen nga vëllimi i energjisë elektrike të furnizuar për këtë kategori klientesh, do të pasqyrohen në menyrë transparente, jo-diskriminuuese dhe do të reflektojnë koston reale të furnizimit, e cila do të monitorohet nga Rregullatori në mënyre periodike.

Furnizuesi i Mundësisë së fundit do të japi çdo muaj evidencë të qartë në formën e nje bilanci energjitik i cili të mund të argumetojë burimin e mbulimit të kërkesës mujore për klientët e FMF.

10. FMF do të kërkojë nga konsumatorët e tij që të depozitojnë një garanci bankare të barabartë me vlerën financiare të furnizimit të pritshëm, vlerë kjo e dakortësuar në marrëveshjen mes palëve, e cila do të çlirohet menjëherë me likuidimin e detyrimeve financiare mes palëve.

Neni 7

Aplikimi për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike për furnizimin nga FMF

1. Furnizuesi i Mundësisë së fundit jo më vonë se data 5 e muajit pasardhës do të paraqesë në ERE aplikimin për përcaktimin e çmimit për shitjet e energjisë elektrike për qëllime të Furnizimit të Mundësisë së Fundit për muajin aktual. Ky aplikim do të përfshijë të gjitha kostot e identifikuara nga Furnizuesi, sipas nenit 6 të kësaj metodologjie.
2. Deri në përcaktimin e çmimit nga ERE, Furnizuesi do të faturojë klientin e furnizuar në kushtet e furnizimit të mundësisë së fundit, me çmimin mesatar të ponderuar të profileve të blerjes së energjisë elektrike të siguruar për periudhën në të cilën furnizohet, publikuar nga FMF, duke pasqyruar kostot administrative, e transmetimit/shperndarjes, sipas nivelit të tensionit ku është i lidhur konsumatori si dhe kostot e përcaktuar në pikën 6 të nenit 6.
3. ERE në çdo rast, do të vendos çmimin e shitjes së energjisë elektrike për Furnizuesin e Mundësisë së fundit jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja e aplikimit. Brenda kësaj periudhe, ERE mund të vendosë për zhvillimin e seancave dëgjimore.
4. Jo më vonë se 5 ditë nga vendimi i ERE për korrigjimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike sipas pikës 2, të këtij neni, mes palëve do të lëshohet një faturë me të gjithë kompensimet për diferencat ndërmjet çmimit të faturuar sipas pikës 3 të këtij neni dhe çmimit të përcaktuar nga ERE.

Neni 8

LLogaritja e Çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

1. C'BEt është çmimi mesatar i ponderuar i profileve të blerjes për sasinë e energjisë së siguruar për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF për periudhën e furnizimit nga tregu i parregulluar dhe nga prodhuesit me përparësi (BRE).

$$\text{ÇFMFt} = \text{CBEt} + Pr * \text{CBEt} + \text{TRrTSHt} + \text{CA}$$

Ku:

CFMFt Çmimi i furnizimit në periudhën relevante *t*

CBEt është çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit nga Tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me preparesi (BRE)

Pr Kthimi per riskun i percaktuar ne perqindje per vitin (do te pranohet ne masen 3% per dy vitet e para e me tej do te rishikohet bazuar ne te dhenat historike)

TRrTSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes për periudhën relevante *t*

CA Kosto administrative te Furnizuesit te Mundesise se Fundit

2. Në çdo rast ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i shitjes me pakicë te klientët që furnizohen në atë nivel tensioni sipas Vendimit të Bordit të ERE-s Nr.148, datë 26.12.2014, kur kete funksion e ushtron OSHEE/ FSHU.
3. Çmimi i energjisë në Pik, duhet të llogaritet dhe të evidentohet nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit bazuar në kostot reale të energjisë së furnizuar në periudhën e pikut. Faturimi në Pik, do të jetë në fashën orare si vijon:]
Për periudhën 1 Nëntor - 31 Mars nga ora 18:00 deri në 22:00
Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri në 23:00

Neni 9

Detyrime te tjera

1. Çmimi i llogaritur sipas përcaktimeve të nenit 6 të kësaj Metodologjie, nuk përfshin detyrimet në lidhje me incentivimin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme dhe detyrimet e tjera tatimore, të cilat furnizuesi i mundësisë së fundit është i detyruar t'i identifikojë në një zë të veçantë në faturën e shitjes së energjisë elektrike për konsumatorin fundor të furnizuar prej tij.
2. FMF ka detyrimin të blejë energji elektrike me shumicë në emër të konsumatorëve të furnizuar prej tij dhe të jetë përgjegjës për balancimin e mbetjes për një furnizim të tillë me shumicë.

3. FMF ka detyrimin e informimit të konsumatorëve për kushtet e shërbimeve të ofruara prej tij.
4. FMF ka detyrimin e dorëzimit të kontratave të furnizimit tek konsumatorët që do të furnizohen prej tij, brenda 8 ditëve nga fillimi i furnizimit.
5. FMF duhet të furnizojë konsumatorët që furnizohen prej tij, për një periudhe jo më të gjatë se *afati i parashikuar ne Neni 3 Ligji 7/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015 si dhe t'i ndihmojë që të gjejnë një furnizues alternativ brenda këtij afati*

Neni 10

Monitorimi i Çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

1. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit duhet të dorëzojë dhe të argumentojë në ERE, për çdo muaj, të gjitha kostot, bazuar në elementët e këtij çmimi, siç përcaktuar në nenin 6 të kësaj metodologjie.
2. FMF duhet të mbajë llogari të ndara për furnizimin e konsumatorëve sipas shërbimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, nga furnizimi i konsumatorëve nga shërbimi i FSHU (Furnizuesi i Shërbimit Universal) si dhe çdo furnizim tjetër tregtar. Këto të dhëna duhet të jenë në dispozicion të ERE-s sa herë që kërkohet prej saj.
3. ERE do të monitorojë dhe kontrollojë përcaktimin e çmimit të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

Neni 11

Publikimi

I licencuari i caktuar me shërbimin e Furnizimit të Mundësisë së Fundit ka detyrimin të mirëmbajë dhe të publikojë në faqen e internetit, informata rreth shërbimit të furnizimit të mundësisë së fundit, tarifat e furnizimit për muajt paraardhës për kategori të ndryshme të konsumatorëve dhe vlerësimin e përafërt për tarifat që mund të aplikohen në muajin pasardhës për konsumatorët që mund të furnizohen nga ky furnizues.

PJESA E TRETË

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 12

Interpretimi

Në rast se, një çështje nuk është trajtuar në këtë Metodologji, ERE do të vendosë rast pas rasti dhe do të nxjerrë udhëzimet sipas kërkesave përkatëse.

Neni 13

Dispozita tranzitore

Llogaritja e çmimit të energjisë së furnizuar në kushtet e furnizimit të mundësisë së fundit, para hyrjes në fuqi të kësaj metodologjie, do të korrigjohet në përputhje me kriteret e përcaktimit të çmimit të furnizuesit të mundësisë së fundit të përcaktuar në këtë metodologji.

Neni 14

Amendime të rregullores

Kjo metodologji është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE, si dhe në përputhje me Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo Metodologji u miratua me vendimin e Bordit të ERE nr 201 datë 04.12.2017, hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.